

 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING			
Njësia Org Org.Jednica Org.Unit	SP-02	Nr.Prot Broj.Prot Prot.No.	8313-2/25
Nr. i faqeve Broj.stranica No.pages	-09-	Data Datum Date	07/09/2026
PRISHTINE/A			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	30.03.2026
REFERENC-Ë:	25/8313/MMPHI
PËR/ZA/TO:	“Plastika” Sh.p.k. Fabrikë e riciklimit të mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Parku i Biznesit, Korroticë e Epërme, Gllogoc
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPH-së
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.25/8313/MMPHI, për t’u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit “Plastika” Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë e riciklimit të mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Parku i Biznesit, Korroticë e Epërme, Gllogoc.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur,

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/8313/MMPHI
Datë: 30.03.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, të nenin 16 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI - Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

Vendim

Aprovohet kërkesa për vazhdimin e Lejes Mjedisore, me Nr.Prot.25/8313/MMPHI për kompaninë "Plastika" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë e riciklimit të mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Parku i Biznesit, Korroticë e Epërme, Glllogoc, në ngastrat kadastrale nr.27/38, nr.27/39, nr.27/40, nr.27/41, nr.27/42, nr.27/43, zona kadastrale Korroticë e Epërme, Glllogoc.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Mbeturinat komunale të vendosen në kontejner dhe të merren nga kompania me të cilën posedoni kontratë;
- Mbeturinat nga procesi teknologjik i prodhimit të merren nga kompania me të cilën posedoni kontratë;

Faqe 2 nga 4



- Për sistemin menaxhues mjedisor të këtë personin e profilit mjedisor;
- Nëse gjatë operimit do të këtë ndonjë prishje teknike e që mund të këtë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH-në;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdimin e Lejes Mjedisore me Nr.Prot.25/8313/MMPHI, të operatorit "Plastika" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë e riciklimit të mbeturinave të plastikës dhe prodhimin e produkteve të plastikës, Parku i Biznesit, Korroticë e Epërme, Gllogoc, në ngastrat kadastrale nr.27/38, nr.27/39, nr.27/40, nr.27/41, nr.27/42, nr.27/43, zona kadastrale Korroticë e Epërme, Gllogoc, si dhe vizitës së realizuar në terren, MMPH konstaton se operatori i ka plotësuar kushtet për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt.30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810327008, datë:12.01.2007, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor, Nr.:16/1371/ZSP/40/20, datë: 17.01.2020, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;

Andaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga pala, gjendjes faktike në terren, mbajtjen e debatit publik, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, të nenin 16 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI - Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, aprovon kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:



- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 25/8313/ZSP/26 datë: 30.03.2026

Baram Kafexholli

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së



Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Glllogocit;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së